



REPUBLI KË KOSOVËS / REPUBLI KË KOSOVA

Ae.nr.101/2020

**GJYKATA E APELI TE KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesve të sigurimit [“T...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj, dhe [“O...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj, të cilët i përfaqësojnë sipas autorizimit [A.SH], [V.I] dhe [A.D] avokatë nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit: [N.H] shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore duke vendosur sipas ankesës së propozuesve të sigurimit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.E.C.nr.491/19, të datës 05.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.07.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** ankesa e propozuesve të sigurimit [“T...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj, dhe [“O...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.E.C.nr.491/19, të datës 05.03.2020, **PRISHET**, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuesve të sigurimit: [“T...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj, dhe [“O...”] sh.p.k., me seli në Ferizaj, i paraqitur kundërshtarit të sigurimit [N.H], me vendbanim në Shkup Republika e Maqedonisë Veriore, si dhe shtetas i Republikës së Kosovës, me [nr. të letërnjoftimit ...] për caktimin e masës së sigurimit, ashtu që ti ndalohej kundërshtarit të sigurimit, që të ndërmarrë, që të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me ndryshimin e të dhënave të propozuesit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, t`i ndalohej çfarëdo veprimi në relacionin me kontratat e lidhura në mes të paditësit dhe Kontratave Komerciale, si dhe që të urdhërohet Agjencisë për Regjistrimi e Bizneseve të Kosovës që mos të lejojë çfarëdo ndryshimi të të dhënave të Propozuesit deri në vendimin e ardhshëm të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë propozuesit e sigurimit, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.E.C.nr.491/19, të datës 05.03.2020 dhe të aprovohej propozimi i propozuesve të

masës së sigurimit ashtu që I.Të caktohet masa e sigurimit, përmes së cilës i ndalohet kundërshtarit të sigurimit z.[N.H] nga Shkupi që të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me ndryshimin e të dhënave në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe i ndalohet çfarëdo veprimi në relacion me Kontratat e lidhura në mes të Propozuesve dhe Bankave Komerciale. II.Të urdhërohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës që të mos lejojë çfarëdo ndryshimi të të dhënave të propozuesit deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK, Gjykata e Apelit ka gjetur :

#### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesit, ["T..." sh.p.k., me seli në Ferizaj, dhe ["O..." sh.p.k., me seli në Ferizaj, me datë 30.09.2019 ka paraqitur pranë gjykatës së shkallës së parë padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit [N.H] shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore me pretendim se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit do të vështirësohej realizimi i kërkesës së tij të parashtuar me padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës së sigurisë.

Në këtë gjendje të çështjes juridike, Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsytet për faktet vendimtare respektivisht arsytet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsytet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në

shkresat e lëndës. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare se si e ka krijuar bindje e saj se pala kundërshtarë nuk do ta pamundësoi apo vështirësoi realizimin e kërkesës së propozuesve në rast të aprovimit të kërkesëpadsisë së tyre.

Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës siguroese, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa i vërtetuar me prova konkrete faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se propozimi i palës propozuese për caktimin e masës siguroese është i pabazuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet se propozuesit nuk kanë treguar me asgjë për ekzistimin e rrezikut por nga shkresat e lëndës rezulton se ekziston rreziku evident se kundërshtari i sigurimit me veprimet e veta të pamundësojë zhvillimin e aktiviteteve në të dy shoqëritë tregtare qoftë përmes marrjes së veprimeve që bien në kundërshtim me detyrimet për

lojalitet qoftë përmes shitjes së aksioneve dhe rrezikimin e propozuesve. Me padi është kërkuar përjashtimi i aksionarit për shkak të shkeljes së detyrimeve ndaj shoqërisë andaj gjykata e shkallës së parë është dashur ta vlerësoj nëse kërkesa e paditësve është e besueshme dhe nëse gjatë kësaj kohe i padituri me veprimet e tij, duke i pasur parasysh autorizimet në shoqëri, mund ta ndryshojë gjendjen në dëm të paditësve.

Gjykata e Apelit e vlerëson të paqëndrueshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe refuzimin e propozimit me arsyetim se, arsyet nga të cilat kërkohet masa e sigurimit - shitja e aksioneve është veprim që nuk ndalohet me statut. Masa e sigurimit lëshohet për ndalimin e veprimeve të cilat janë të lejuara, por me ndërmarrjen e tyre mund të shkaktohet dëm për palën kundërshtarë. Për veprimet të cilat janë të ndaluara me ligj nuk është e nevojshme të ndalohen me masa të sigurimit sepse ato i ndalon vete ligji dhe nuk krijojnë efekt juridik edhe po të ndërmerren.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetoi faktet relevante të sipërpërmendura, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet nga Neni 297 par.1 i LPK-së, ashtu që pastaj, lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ae.nr.101/2020, me dt.13.07.2020**

**Kryetari i kolegjit gjyqtari,**  
**Mahir Tutuli, dv.**

